

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 23.05.2022	Numri i vrojtimit të lejes:	07 Nr.204/350-25833
-------------------------	------------------------------------	----------------------------

- Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Naser Bytyçi nga Peqani, Komuna Suharekë, me 07 Nr.350-25833 të datës 29.04.2022 - në të cilën kërkon dhënien e lejes për shfrytëzimin e hapsirës publike, në bazë të nenit 8 alinea 8.9 pika 8.9.2 të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015, nenit 5 pika 5.2 al. 5.2.2, nenit 8 pika 8.3, nenit 9 al. 9.19.7, nenit 11, 12, 13 dhe 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private 01-Nr.16-4719 të datës 30.06.2016 si dhe Procesverbalit 07Nr.188/350-25833 të datës 18.05.2022, bie këtë:

P Ë L Q I M

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Naser Bajram Bytyçi	Nr. Personal	
Adresa:	Fshati Peqan.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim-për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një aparati lëvizës për shitjen e akullloreve dhe ruajtjen e tyre.

Përshkrimi:

I LEJOHET - investuesit - z. **Naser Bytyçi** nga Peqani, Komuna Suharekë, shfrytëzimi i hapsirës publike për vendosjen e një aparati lëvizës për shitjen e akullloreve dhe ruajtjen e tyre (aparati nuk duhet të jetë më i madh se 2.00m²), në një sipërfaqe prej **5.00 m²**, në parcelën kadastrale Nr.680-0 dhe Nr.680-1, pasuri shoqërore, në zonën kadastrale Suharekë, në rrugën "Brigada - 123"- vendi i quajtur sheshi "Ibrahim Rugova", Komuna Suharekë.

Vendosja e aparatit lëvizës për shitjen e akullloreve dhe ruajtjen e tyre, si dhe shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës shoqërore - hapsirës publike - **lejohe me karakter të përkohshëm sezonal** dhe vlen nga data **18.05.2022** deri më **31.10.2022**, me mundësi të vazhdimit pas shqyrtimit të rrethanave të reja të krijuara dhe dispozitave tjera ligjore .

Shfrytëzuesi do të shfrytëzojë hapsirën publike në një sipërfaqe prej **5.00 m²**, për të cilën do të paguaj sipas Rregullores së Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pasurisë - tokës shoqërore, dhe atë **3 euro për m² në muaj**, shuma për pagesë prej **18.05.2022** deri më **31.10.2022** është gjithsejtë : **81.72 Euro**.

Investuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër.

Gjithashtu hapësira e cila i jepet në shfrytëzim nuk lejohet të kufizohet (rrethohet) .

Trotuari duhet të jetë i lirë dmth. shfrytëzimi i sipërfaqes së lejuar duhet të shfrytëzohet në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve (këmbësorëve) në trotuar.

Për nevoja më të mëdha të realizimit të planit urbanistik të asaj pjese të Suharekës, ku lejohet shfrytëzimi i kësaj hapësire për vendosjen e përkohshme të objektit të cituar më lartë, investuesit edhe para skadimit të afatit të caktuar me këtë Pëlqim mundet të i bihet Aktvendimi për menjanimin e objektit në fjalë, pa kurrfarë kompensimi nga ky Organ e në shpenzime të vet investuesit .

Me rastin e festave kombëtare, tubimeve dhe për nevoja të tjera nga drejtoria e Urbanizmit - jeni të obliguar që objektin e cekur më lartë ta menjani për një kohë të caktuar .

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi, inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj.

A r s y e t i m

Duke e shqyrtuar kërkesën e investuesit z. **Naser Bytyçi** nga Peqani, Komuna Suharekë, ky Organ konstatoi se kërkesa është e arsyeshme dhe se të përmendurit mundet të i lejohet vendosja e një aparati lëvizës për shitjen e akullloreve dhe ruajtjen e tyre si dhe shfrytëzimi i pasurisë - hapësirës publike, në një sipërfaqe prej **5.00m²**, me afat të caktuar me këtë Pëlqim.

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të tokës ndërtimore.

Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe shfrytëzim të hapësirës publike konform Rregullores mbi tarifatat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5.- në vlerë prej **15.00 euro**.


Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtit .

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe Dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës :

Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë:

Visar Kuçi

